

LIGJ
Nr.9126, datë 29.7.2003

**PËR PËRDORIMIN CIVIL TË LËNDËVE PLASËSE DHE LËNDËVE
PIROTEKNIKE DHE FISHEKZJARRË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

*(ndryshuar me ligjin nr. 10137, datë 11.5.2009, me ligjin nr. 10 388, datë 3.3.2011; me ligjin nr. 73/2014,
datë 10.7.2014)*

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

(shtuar fjalë me ligjin nr. 10 388, datë 3.3.2011)

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i procedurave, rregullave dhe i përgjegjësiive të administratës shtetërore për prodhimin, magazinimin, përdorimin, kontrollin, asgjësimin, transferimin dhe mënyrën e tregtimit, si dhe regjistrimin e gjurmimit të lëndëve plasëse për përdorim civil, për mbrojtjen dhe sigurimin e jetës, të shëndetit të njerëzve, kafshëve, vlerave materiale dhe mjedisit nga rreziqet, që mund të shkaktojnë këto lëndë.

Neni 2

Fusha e zbatimit të ligjit

(zëvendësuar fjalë me ligjin nr. 10137, datë 11.5.2009, shtuar pika 3 me ligjin nr. 10 388, datë 3.3.2011)

1. Ky ligj zbatohet nga të gjithë personat fizikë ose juridikë, që merren me prodhimin, magazinimin, transferimin, importimin, tregtimin dhe përdorimin e lëndëve plasëse për përdorim civil, të pajisur me licencë ose autorizim për ushtrimin e veprimtarisë me lëndë plasëse.

2. Ky ligj nuk zbatohet për lëndët plasëse, që përdoren nga Forcat e Armatosura dhe ato të Rendit Publik, përdorimi i të cilave rregullohet me ligj të veçantë.

3. Dispozitat e këtij ligji, të cilat rregullojnë prodhimin, importin, eksportin dhe magazinimin e lëndëve plasëse për përdorim civil, zbatohen edhe për prodhimin, importin, eksportin dhe magazinimin e lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrë. Nuk zbatohen, për lëndët piroteknike dhe fishekzjarrë, dispozitat e këtij ligji për regjistrimin, gjurmimin, transferimin dhe përdorimin e lëndëve plasëse për përdorim civil.

Përkufizime

(ndryshuar fjalia e dytë e pikës 2, ndryshuar pika 3, shtuar fjalë në pikën 7, shtuar pikat 9, 10 dhe 11 me ligjin nr. 10 388, datë 3.3.2011, shtuar pika 12 me ligjin nr. 73/2017, datë 10.7.2014)

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Administrim lëndësh plasëse" është prodhimi, ambalazhimi, magazinimi, shpërndarja, transferimi, tregtimi, përdorimi dhe asgjësimi i lëndëve plasëse për përdorim civil, në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregullat tekniko-administrative të këtij ligji.

2. "Lëndë plasëse" janë të gjitha ato bashkime ose përzierje të ndryshme kimike, të cilat, pa praninë e oksigjenit, nën ndikimin e ngacmimeve të jashtme, pësojnë ndryshime shumë të shpejta fiziko-kimike, të shoqëruara me temperaturë të lartë dhe çlirim gazrash në sasi e presion të lartë, të afta për të kryer punë, të cilat plotësojnë standardet e përdorimit në veprimtari civile. Lëndë plasëse për përdorim civil janë materialet dhe artikujt e përcaktuar si të tillë në "Rekomandimet e Kombeve të Bashkuara për transportin e mallrave të rrezikshme", ratifikuar me ligjin nr.9272, datë 16.9.2004 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen evropiane "Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme, ADR" dhe protokollin e nënshkrimit", dhe që nuk bëjnë pjesë në listën e mallrave ushtarake e të mallrave me përdorim të dyfishtë, miratuar në zbatim të ligjit nr.9707, datë 5.4.2007 "Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë.

3. Lëndët piroteknike dhe fishekzjarrë për përdorim civil, që lejohen të importohen, eksportohen apo prodhohen në Republikën e Shqipërisë, janë ato mallra, transformimi i të cilave bëhet vetëm me djegie, me shpejtësi 1-10 m/sek, të cilët lëshojnë flakë dhe dritë, me ndriçim, me ngjyra të ndryshme, dhe që përcaktohen në pjesën II, klasa I, grupet 3 e 4, me kod klasifikimi 1.3G ose 1AG, siç parashikohet në marrëveshjen evropiane për transportin rrugor ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme (ADR), ratifikuar me ligjin nr.9272, datë 16.9.2004.

4. "Parti lëndësh plasëse" është një sasi e caktuar lëndësh plasëse (në copë, në vëllim ose në masë), prodhuar në kushte tërësisht të barabarta, shoqëruar me specifikime teknike.

5. "Sigurim" është tërësia e rregullave dhe e masave me karakter teknik për shmangien e rreziqeve, që vijnë nga prodhimi, magazinimi, transferimi dhe përdorimi i lëndëve plasëse për përdorim civil.

6. "Specifikime teknike" janë specifikimet e dhëna në një dokument për karakteristikat e kërkuara për një produkt si: niveli i cilësisë, vetitë, siguria, përmasat, përfshirë edhe terminologjinë, simbolet, provat, metodat e analizave, paketimin dhe etiketimin e produktit.

7. "Transferim" është lëvizja fizike nga një vend në tjetrin e një partie lëndësh plasëse për përdorim civil brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, duke përjashtuar këtu spostimet brenda së njëjtës strukturë.

8. "Vlerësim konformiteti" janë veprimet për përcaktimin dhe plotësimin e kërkesave teknike, të vendosura për prodhimin, magazinimin, transferimin dhe përdorimin e lëndëve plasëse për përdorim civil.

9. "Siguria publike", në kuptim të këtij ligji, është parandalimi i përdorimit të kundërligjshëm dhe kundër rendit publik.

10. "Gjurmimi" është një sistem i përshtatshëm identifikimi për përcaktimin e saktë të

vendndodhjes së lëndëve plasëse për përdorim civil, nga prodhimi apo importimi deri te përdorimi i fundit, si dhe të poseduesit të saj në të gjitha fazat.

11. "Regjistrim" është sistemi ku hidhen të dhënat, për hyrjet e daljet nga territori i Republikës së Shqipërisë të lëndëve plasëse për përdorim civil, si dhe për lëvizjet (shitblerjet) brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, deri tek identifikimi i përdoruesit të fundit.

12. "Vërtetim besueshmërie" është akti administrativ i organit përgjegjës të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, ku dokumentohet procesi i verifikimit të të dhënave të individit në raport me ato të regjistrave fizikë dhe elektronikë të të gjitha institucioneve shtetërore.

KREU II KËRKESAT KRYESORE TË SIGURISË

Neni 4

(hiqen fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 10 388, datë 3.3.2011)

1. Lëndët plasëse për përdorim civil duhet të jenë në përputhje me kërkesat e sigurisë, që jepen dhe zbatohen ndaj tyre.

2. Çdo lëndë plasëse duhet:

a) të jetë e projektuar, prodhuar, ambalazhuar, magazinuar dhe shpërndarë në mënyrë që të mos cenojë sigurinë për jetën dhe shëndetin e njerëzve, të parandalojë dëmtimet ndaj pronës dhe mjedisit, në kushtet normale, të parashikuara, veçanërisht për rregullat e sigurisë dhe praktikatat standarde ekzistuese në kohën që ajo përdoret;

b) të ketë simbolet dhe fjalët karakteristike, në përputhje me rregullat ndërkombëtare, që përdoren për lëndët e rrezikshme, të përcaktuara nga prodhuesi për siguri dhe besueshmëri maksimale;

c) të kontrollohet në kushte reale. Nëse kontrollet nuk mund të bëhen në laborator, ato duhet të bëhen në kushtet ku lënda plasëse do të përdoret.

Neni 5

Klasifikimi për përdorim civil i lëndëve plasëse

1. Çdo lëndë plasëse për përdorim civil duhet të klasifikohet sipas partive në bazë:

a) të strukturës dhe vetive karakteristike, ku përfshihen përbërja kimike, shkalla e përzierjes dhe, aty ku është e nevojshme, përmasat dhe shpërndarja sipas masave të kokrrizave;

b) të qëndrueshmërisë kimike dhe fizike në të gjitha kushtet mjedisore, ku mund të ekspozohet, dhe pajtueshmërisë së përbërësve për qëndrueshmërinë kimike dhe fizike;

c) të ndjeshmërisë ndaj goditjeve dhe fërkimit;

ç) të pastërtisë kimike;

d) të qëndrueshmërisë ndaj ndikimit të ujit, kur është parashikuar të përdoret në lagështi ose në kushte të lagështisë dhe ku siguria e besueshmëria mund të dëmtohen rëndë nga uji;

dh) të qëndrueshmërisë ndaj temperaturave, të larta dhe të ulëta, atje ku lënda plasëse është parashikuar për t'u mbajtur ose përdorur, në temperatura të tilla dhe atje ku siguria ose besueshmëria e saj mund të dëmtohet nga ftohja ose nxehja e përbërësve të lëndës plasëse;

e) të përshtatshmërisë për përdorim në mjedise të rrezikshme (për shembull mjedisi i rrezikuar nga gazi i minierës, masa të nxehta etj.), kur është parashikuar për t'u përdorur në kushte të tilla;

ë) të vetive të sigurisë, të parashikuara për të parandaluar iniciimin ose ndezjen e parakohshme ose të pakujdesshme;

f) të ngarkesës dhe funksionimit korrekt;

g) të udhëzimeve të përshtatshme në gjuhën shqipe dhe, atje ku është e domosdoshme, marketimin për trajtimin, magazinimin, përdorimin dhe asgjësimin e sigurt;

gj) të aftësisë, ambalazhit ose përbërësve të tjerë për t'i rezistuar prishjes gjatë magazinimit deri në datën e përdorimit, të përcaktuar nga prodhuesi;

h) të specifikimeve të të gjithë mekanizmave dhe aksesorëve, që nevojiten për funksionim të sigurt dhe të besueshëm;

i) të gazrave të prodhuara prej tyre, gjatë përdorimeve nëntokësore, të cilat përmbajnë monoksid karboni, gazra nitrike, gazra të tjera, avuj ose mbetje të ngurta, të ngritura në ajër vetëm në sasi që nuk dëmtojnë shëndetin;

j) të kohëve të vonesës ndërmjet kapsollave elektrike me veprim të vonuar, që duhet të jenë të mjaftueshme, uniforme, për të siguruar që mundësia e kapërcimit të kohës së detonimit nga një detonator te tjetri të jetë e sigurt;

k) të karakteristikave të kapsollave elektrike, të cilat duhet të tregohen mbi paketim (për shembull rryma e mosshpërthimit, qëndrueshmëria etj.);

l) të telave të kapsollave elektrike, që duhet të jenë të izoluara mjaftueshëm dhe me qëndrueshmëri mekanike, përfshirë edhe qëndrueshmërinë e lidhjeve në detonator, duke pasur parasysh përdorimin e parashikuar.

2. Rregullat teknike (standardet) të lëndëve plasëse për përdorim civil përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6

Testimi i lëndëve plasëse për përdorim civil

(zëvendësuar fjalë me ligjin nr. 10137, datë 11.5.2009)

1. Lëndët plasëse, që i përkasin sferës së veprimtarisë së këtij ligji, duhet të përmbushin kërkesat kryesore të sigurisë, të përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji.

2. Para se një lëndë plasëse për përdorim civil të hidhet në treg, prodhuesit, importuesit dhe eksportuesit janë të detyruar të kryejnë procedurat e mëposhtme të vlerësimit të konformitetit të lëndës plasëse:

a) ekzaminimin tip EC (moduli B);

i) konformitetin tip (moduli C);

ii) procedurën e garancisë së cilësisë së produktit (Moduli E);

iii) verifikimin e produktit (moduli F);

b) verifikimin e produktit (moduli G).

Të dhënat dhe kërkesat për këto module jepen në aneksin 1.

3. Prodhuesit, importuesit dhe përdoruesit e lëndëve plasëse për përdorim civil, janë të detyruar t'i japin personit fizik ose juridik, të licencuar për kryerjen e këtij vlerësimi, të gjitha të dhënat që kërkohen për vlerësimin e konformitetit.

4. Vetitë e lëndëve plasëse testohen vetëm me metoda, që plotësojnë parimet e mbrojtjes

dhe të sigurisë së jetës së njerëzve, kafshëve, vlerave materiale dhe mjedisit.

5. Vetitë e lëndëve plasëse për përdorim civil testohen vetëm nga persona juridikë ose fizikë, të licencuar për kryerjen e kësaj veprimtarie, të pajisur me certifikatën e laboratorit të akredituar. Personat e licencuar për këtë veprimtari janë të detyruar t'i demonstrojnë Ministrisë së Mbrojtjes pajtimin me praktikën e laboratorit të akredituar. Shpenzimet për testimin e lëndëve plasëse mbulohen nga prodhuesi ose importuesi.

6. Një certifikatë e pajtimit të praktikës së laboratorit të akredituar, e dhënë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, është e barasvlershme me certifikatën e dhënë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në rast se plotëson të gjitha kushtet e parashikuara në këtë ligj.

KREU III ADMINISTRIMI I LËNDËVE PLASËSE PËR PËRDORIM CIVIL

Neni 7

(shtuar paragraf në fund të pikës 1, zëvendësuar fjalë në pikat 2 dhe 3 me ligjin nr. 10137, datë 11.5.2009, shtuar fjalë në pikën 5 me ligjin nr. 10 388, datë 3.3.2011, shtuar fjalë në pikën 1 dhe 3 me ligjin nr. 73/2017, datë 10.7.2014)

1. Lëndët plasëse për përdorim civil prodhohen, importohen dhe eksportohen në Republikën e Shqipërisë vetëm me licencë nga Ministria e Mbrojtjes, pasi personi juridik apo fizik të jetë pajisur me vërtetim besueshmërie të lëshuar nga ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike.

Të gjitha veprimtaritë, që i nënshtrohen licencimit, sipas këtij ligji, përfshihen në kategorinë I.1 të shtojcës së ligjit për licencat. Këto veprimtari licencohen në përputhje me dispozitat vijuese të këtij ligji. Miratimi në heshtje nuk zbatohet në rastin e këtyre licencimeve.

2. Lëndët plasëse për përdorim civil transferohen, magazinohen dhe asgjësohen vetëm me autorizim nga ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike.

3. Lëndët plasëse për përdorim civil përdoren vetëm me autorizim nga ministria përgjegjëse për energjinë dhe industrinë, pasi personi juridik apo fizik të jetë pajisur me vërtetim besueshmërie të lëshuar nga ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike.

4. Lëndët plasëse për përdorim civil futen në Republikën e Shqipërisë pasi të jenë kontrolluar nga Ministria e Mbrojtjes, e cila kryen procedurat e konformitetit të tyre.

5. Ministria e Mbrojtjes merr të gjitha masat për regjistrimin, gjurmimin dhe identifikimin e lëndëve plasëse në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për të kufizuar ose ndaluar hedhjen në treg të lëndëve plasëse për përdorim civil, që rrezikojnë sigurinë, edhe kur kanë të shënuar marketimin e konformitetit CE.

6. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes, vendos masa të përkohshme, të domosdoshme për tërheqjen e lëndës plasëse nga tregu, ndalimin në treg dhe lëvizjen e lirë të saj.

Neni 7/1

Lëndët piroteknike e fishekzjarrë për përdorim civil

(shtuar me ligjin nr. 10 388, datë 3.3.2011, ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 73/2014, datë 10.7.2014)

1. Këshilli i Ministrave përcakton procedurat për dhënien e licencës për prodhimin, importimin, eksportimin, magazinimin e lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrë.

2. Ministria e Mbrojtjes kontrollon, verifikon, ndjek dhe zbaton prodhimin, importimin dhe eksportimin e lëndëve piroteknike e fishekzjarrë dhe përcakton, me rregullore të veçantë, mënyrën, kushtet dhe kriteret.

3. Ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike kontrollon, verifikon, ndjek zbatimin e rregullave të magazinimit e përdorimit të lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve, si dhe përcakton me rregullore të veçantë mënyrën, kushtet dhe kriteret e magazinimit e përdorimit të tyre.

Neni 8

Regjistrimi i lëndëve plasëse

(shtuar pika 5 me ligjin nr. 73/2014, datë 10.7.2014)

1. Prodhuesi, importuesi dhe eksportuesi janë të detyruar të regjistrojnë lëndët plasëse, që prodhojnë dhe hedhin në treg, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Në Ministrinë e Mbrojtjes mbahet regjistri shtetëror për lëndët plasëse. Dokumentet për aplikimin për regjistrim dhe mënyra e plotësimit të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Prodhuesi dhe importuesi janë të detyruar të njoftojnë, brenda 10 ditëve, Ministrinë e Mbrojtjes për çdo ndryshim në të dhënat e aplikimit për regjistrim.

4. Të dhënat, publikimi i të cilave dëmton prodhuesin dhe importuesin, gjatë procesit të regjistrimit, me kërkesën e tyre, specifikohen "sekret".

5. Ministria e Mbrojtjes dërgon pranë ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike të dhënat e subjekteve të regjistruara në regjistrin shtetëror për lëndët plasëse.

Neni 9

Kushtet e përgjithshme të administrimit

(zëvendësuar fjalë në pikën 4 me ligjin nr. 10 388, datë 3.3.2011, ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 73/2014, datë 10.7.2014)

1. Këshilli i Ministrave përcakton procedurat për dhënien e licencës ose autorizimit për prodhimin, importimin, eksportimin, magazinimin, transferimin, përdorimin, asgjësimin e lëndëve plasëse, si dhe për dhënien e vërtetimit të besueshmërisë.

2. Ministrinë e ngarkuara, sipas nenit 7 të këtij ligji, në bazë të aplikimit me shkrim të kërkuarit, i japin licencën ose autorizimin përkatës, në mbështetje të kriterëve të kualifikimit profesional dhe të gjendjes shëndetësore, personit fizik ose juridik, që ka vendbanimin në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që nuk ka kryer vepra penale.

3. Marrja e licencës nga autoritetet vendore, për sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit, është kusht për administrimin e lëndëve plasëse për përdorim civil.

4. Personi fizik dhe juridik, i pajisur me licencë për import ose eksport të lëndëve plasëse për përdorim civil, është i detyruar, që për çdo ngarkesë, të njoftojë 7 ditë përpara Ministrinë e Mbrojtjes.

5. Leja e dhënë nuk i transferohet personave të tjerë.

Neni 10

Gjurmimi dhe identifikimi i lëndëve plasëse

(ndryshuar me ligjin nr. 10 388, datë 3.3.2011)

1. Subjektet tregtare, në fushën e prodhimit, importimit, eksportimit, përdorimit dhe asgjësimit të lëndëve plasëse për përdorim civil, të disponojnë një sistem efikas të gjurmimit të lëndëve plasëse për përdorim civil. Ky sistem të mundësojë identifikimin, në çdo fazë, të posedimit të këtyre mallrave, nga prodhimi, importimi, hedhja në treg për herë të parë dhe deri te përdorimi i fundit i tyre.

2. Ministria e Mbrojtjes merr të gjitha masat që subjektet me veprimtari tregtare në sektorin e lëndëve plasëse të pajisen më një sistem për mbledhjen e të dhënave, i cili të përfshijë identifikimin unik dhe poseduesin e tyre, gjatë gjithë fazave të procesit, nga prodhimi apo importimi deri në përdorimin e fundit, gjatë gjithë jetëgjatësisë së lëndëve plasëse për përdorim civil, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

3. Ministria e Mbrojtjes merr të gjitha masat që ngritja dhe funksionimi i një sistemi të harmonizuar të gjurmimit dhe identifikimit të lëndëve plasëse për përdorim civil, në përputhje me aktet normative të Bashkimit Europian, të bëhet brenda datës 31 dhjetor 2012.

4. Rregullat dhe procedurat e krijimit të sistemit të gjurmimit dhe identifikimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Ministria e Mbrojtjes kontrollon, verifikon, ndjek dhe zbaton sistemin e gjurmimit e të identifikimit dhe përcakton, me rregullore të veçantë, mënyrën, kushtet dhe kriteret.

Neni 11

Dispozita të fundit

Aneksi "Vlerësimi i konformitetit" është pjesë e këtij ligji.

Neni 12

Akte të tjera të nevojshme

(shtuar fjalë në pikën 2, zëvendësuar fjalë me ligjin nr. 10 388, datë 3.3.2011)

1. Ministri i Mbrojtjes, ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, ministri përgjegjës për energjinë dhe industrinë nxjerrin udhëzimet përkatëse, në zbatim të nenit 7 pikat 1, 2 e 3 dhe nenit 10 pika 5 të këtij ligji.

2. Këshilli i Ministrave nxjerr aktet nënligjore në zbatim të nenit 5 pika 2, nenit 7/1 pika 1, nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1 dhe nenit 10 pika 4 të këtij ligji.

Neni 13

Çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3933, datë 14.8.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

ANEKSI I

VLERËSIMI I KONFORMITETIT

1. MODULI B: Ekzaminimi tip EC

1. Ky model përshkruan atë pjesë të procedurës, nëpërmjet së cilës një organ i akredituar verifikon dhe vërteton që një mostër, përfaqësuese e produktit të shqyrtuar, plotëson dispozitat përkatëse të ligjit.

2. Aplikimi i ekzaminimit tip EC paraqitet nga prodhuesi ose përfaqësuesi i licencuar i tij, të ngritur brenda komunitetit, tek organi i akredituar, i zgjedhur prej tij.

Ky aplikim duhet të përfshijë:

- emrin dhe adresën e prodhuesit, nëse aplikimi paraqitet nga përfaqësuesi i tij, duhet të jepet emri dhe adresa e tij shtesë;
- një deklaratë me shkrim, që një aplikim i tillë nuk ka qenë paraqitur tek ndonjë organ tjetër i akredituar;
- dokumentet teknike, siç përshkruhet në kreun 3.

Aplikuesi duhet të vërë në dispozicion të organit të akredituar një mostër përfaqësuese të prodhimit të shqyrtuar, që këtej e tutje quhet "tip". Organi i akredituar mund të kërkojë mostra të tjera, në qoftë se nevojiten për plotësimin e programit të kontrollit.

3. Dokumentet teknike duhet të japin mundësinë e vlerësimit të konformitetit të produktit, me kërkesat e ligjit. Ato, aq sa u takon për këtë vlerësim, duhet të mbulojnë projektin, prodhimin dhe funksionimin e produktit dhe të përmbajnë aq sa duhen për vlerësim:

- një përshkrim tip të përgjithshëm;
- projektin konceptual, skicime të prodhimit dhe diagrama të komponentëve, në përmbledhje, qarqe etj.;
- përshkrime dhe shpjegime të domosdoshme, për kuptimin e skicimeve dhe diagramave dhe të funksionimit të produktit;
- një listë të standardeve kombëtare që shndërrojnë standardet e harmonizuara, të zbatuar plotësisht ose pjesërisht dhe përshkrime të zgjidhjeve të adoptuara për të plotësuar kërkesat esenciale të ligjit, atje ku standardet nuk kanë qenë zbatuar;
- rezultatet e kalkulimeve të bëra të projektit, ekzaminimet e kryera etj.;
- raportet e kontrolleve.

4. Organi i akredituar duhet:

4.1. Të ekzaminojë dokumentet teknike, të verifikojë tipin, nëse është prodhuar në konformitet me këto dokumente dhe të identifikojë elementët, që janë projektuar, në përputhje me dispozitat e standardeve, gjithashtu dhe komponentët, që janë projektuar pa zbatuar dispozitat përkatëse të këtyre standardeve.

4.2. Të kryejë ose të ketë kryer ekzaminimet përkatëse dhe testet e domosdoshme, për të kontrolluar, nëse atje ku standardet nuk janë zbatuar, nëse zgjidhjet e adoptuara nga prodhuesi, plotësojnë kërkesat e këtij ligji.

4.3. Të kryejë ose të ketë kryer ekzaminimet përkatëse dhe testet e domosdoshme, për të kontrolluar atje ku prodhuesi ka zgjedhur të zbatojë standardet përkatëse, nëse këto aktualisht janë zbatuar.

4.4. Të merret vesh me aplikantin për vendin ku do të bëhen ekzaminimet dhe testet e domosdoshme.

5. Atje ku tipi plotëson dispozitat përkatëse të këtij ligji, organi i akredituar i jep aplikantit një certifikatë ekzaminimi tip EC. Certifikata përmban emrin dhe adresën e prodhuesit, konkluzionet e ekzaminimit dhe të dhënat e domosdoshme për identifikimin e tipit të miratuar.

Një listë e pjesëve përkatëse të dokumenteve teknike i shtohet certifikatës dhe një kopje mbahet nga organi i akredituar.

Në qoftë se prodhuesi ose përfaqësuesi i licencuar i tij, të ngritur në komunitet, i është refuzuar një certifikatë tip, duhet që organi i akredituar të japë arsye të hollësishme për këtë refuzim.

Veprimi duhet bërë për një procedurë apelimi.

6. Aplikuesi informon organin e akredituar për dokumentet teknike, që mban në lidhje me certifikatën ekzaminuese tip EC, të të gjitha modifikimeve të produktit të miratuar, për të marrë miratim shtesë, atje ku këto ndryshime mund të dëmtojnë konformitetin, me kërkesat esenciale ose me kushtet e përcaktuara për përdorim të produktit. Ky miratim shtesë jepet në formën e një shtojce në certifikatën ekzaminuese tip EC.

7. Çdo organ i shpallur duhet t'i komunikojë organeve të tjera të akredituara, informacionin në lidhje me certifikatën ekzaminuese dhe shtojcat e dhëna ose të anuluar.

8. Organet e tjera të akredituara mund të marrin kopjet e certifikatave ekzaminuese tip EC ose shtojcat e tyre.

9. Prodhuesi ose përfaqësuesi i tij, i ngritur brenda komunitetit, duhet të mbajë së bashku me kopjet e dokumenteve teknike të certifikatave ekzaminuese EC dhe shtojcat e tyre, për një periudhë kohe së paku 10-vjeçare, pas datës së fundit të prodhimit të produktit të interesuar.

Detyrimi për mbajtjen e dokumenteve teknike në dispozicion është përgjegjësi e personit që vendos produktin në treg.

2. MODULI C: Konformiteti ndaj tipit

1. Ky modul përshkruan atë pjesë të procedurës, nëpërmjet së cilës prodhuesi ose përfaqësuesi i tij, i ngritur brenda komunitetit, siguron dhe deklaron që lënda plasëse e interesuar është në konformitet me tipin, siç përshkruhet në certifikatën ekzaminuese tip EC dhe kënaqin kërkesat e këtij ligji, që aplikohet për to. Prodhuesi duhet të vendosë shenjë CE në çdo lëndë plasëse dhe përpilon një deklaratë me shkrim për konformitetin.

2. Prodhuesi duhet të marrë të gjitha masat e domosdoshme për të siguruar që procesi i prodhimit siguron konformitet të produktit të prodhuar me tipin, siç përshkruhet në certifikatën ekzaminuese tip EC dhe me kërkesat kryesore të sigurisë.

3. Prodhuesi ose përfaqësuesi i licencuar i tij duhet të mbajë një kopje të deklaratës të konformitetit për një periudhë së paku 10-vjeçare, pas datës së fundit të prodhimit të produktit.

Detyrimi për mbajtjen e dokumentave teknike në dispozicion është përgjegjësi e personit që vendos produktin në treg.

4. Një organ i akredituar, i zgjedhur nga prodhuesi, duhet të kryejë ekzaminime të produktit në intervale jo të rregullta. Një mostër e përshtatshme e produktit të përfunduar, e

marrë në vendin e prodhimit nga organi i akredituar, ekzaminohet dhe kontrollohet, siç përcaktohet në standardin e aplikuar, ose në standardin e harmonizuar, ose kryhen kontrole ekuivalente për të kontrolluar konformitetin e produktit me kërkesat e ligjit korrespondues. Organi i akredituar duhet të marrë masat e duhura në rastin kur një ose më shumë mostra të ekzaminuara nuk janë në konformitet.

Nën përgjegjësinë e organit të akredituar, prodhuesi duhet të vendosë simbolin e identifikimit të organit akreditues gjatë procesit të prodhimit.

3. MODULI D: Garancia e cilësisë së prodhimit

1. Ky model përshkruan procedurën, nëpërmjet së cilës prodhuesi, që kënaq detyrimet e harmonizimit të ligjeve, të lidhura me lëndët plasëse, siguron dhe deklaron që lënda plasëse është në konformitet me tipin, siç përshkruhet në certifikatën ekzaminuese tip EC dhe kënaqin kërkesat e këtij ligji. Prodhuesi vendos shenjën CE në çdo lëndë plasëse dhe përpilon një deklaratë me shkrim për konformitetin. Shenja CE shoqërohet me simbolin e identifikimit të organit të akredituar, të përgjegjshëm për kontrollet.

2. Prodhuesi duhet të punojë me një sistem cilësie të miratuar për prodhimin me inspektim të produktit të përfunduar dhe me testimet përkatëse.

3. Sistemi i cilësisë.

3.1. Prodhuesi paraqet një aplikacion për vlerësimin e sistemit të vet të cilësisë, për lëndët plasëse të interesuara, tek organi i akredituar, i zgjedhur prej tij.

Aplikimi duhet të përmbajë:

- gjithë informacionin përkatës për kategorinë e lëndës plasëse të shqyrtuar;
- dokumentet në lidhje me sistemin e cilësisë;
- dokumentet teknike që i përkasin tipit të miratuar dhe një kopje të certifikatës ekzaminuese tip EC.

3.2. Sistemi i cilësisë duhet të sigurojë konformitetin e lëndëve plasëse me tipin, siç përshkruhet në certifikatën ekzaminuese tip EC dhe me kërkesat e këtij ligji që aplikohet ndaj tyre.

Të gjitha dokumentet, kërkesat dhe dispozitat e adoptuara nga prodhuesi, duhet të dokumentohen në mënyrë sistematike. Dokumentet e sistemit të cilësisë duhet të lejojnë një interpretim të qëndrueshëm të programeve, planeve dhe manualeve.

Në mënyrë të veçantë duhet të përmbajë një përshkrim të:

- objektivave të cilësisë dhe strukturën organizative, përgjegjësi dhe fuqinë e drejtimit në lidhje me cilësinë e lëndëve plasëse;
- prodhimit, kontrollit të cilësisë dhe teknikave të garantimit të cilësisë, proceseve dhe veprimeve sistematike që do të përdoren;
- ekzaminimeve dhe testeve që do të kryhen përpara, gjatë dhe pas prodhimit, si dhe frekuencës me të cilën ato do të kryhen;
- dokumentimeve të cilësisë, si për shembull, raportet e inspektimit dhe të dhënave të testit, të dhënave të kalibrimit, raporteve të kualifikimit të personelit të interesuar etj.;
- mënyrave të monitorimit dhe arritjes së cilësisë së kërkuar të lëndës plasëse dhe veprimeve efektive të sistemit të cilësisë.

3.3. Organi i akredituar duhet të vlerësojë sistemin e cilësisë, për të përcaktuar nëse ai kënaq kërkesat për të cilat flitet në 3.2. Ai duhet të presupozojë konformitet me këto kërkesa, në

lidhje me sistemet e cilësisë, që përmbushin standardin e harmonizuar përkatës. Ekipi i kontrollit duhet të ketë së paku një anëtar me eksperiencë për vlerësimin e teknologjisë së produktit përkatës. Procedura e vlerësimit përfshin një njohje me ambientet e prodhuesit.

Vendimi i njoftohet prodhuesit. Njoftimi duhet të përmbajë konkluzionet e ekzaminimit dhe vendimin e vlerësimit.

3.4. Prodhuesi duhet të marrë përsipër të plotësojë detyrimet, që rrjedhin nga sistemi i cilësisë i miratuar dhe zbatojë atë në nivelin e kërkuar.

Prodhuesi ose përfaqësuesi i licencua i tij duhet të mbajë të informuar organin e akredituar, që e ka miratuar sistemin e cilësisë, mbi çdo ndryshim të propozuar në sistemin e cilësisë.

Organi i akredituar duhet të vlerësojë ndryshimet e propozuara dhe të vendosë, që sistemi i cilësisë, i ndryshuar, kënaq kërkesat për të cilat flitet në paragrafin 3.2., ose nëse kërkohet një rivlerësim.

Ai duhet të njoftojë prodhuesin për vendimin e tij. Vendimi duhet të përmbajë konkluzionet e ekzaminimit dhe vendimin e vlerësimit konkret.

4. Monitorimi nën përgjegjësinë e organit të akredituar.

4.1. Qëllimi i monitorimit është që të bëhet e sigurt që prodhuesi përmbush siç duhet detyrimet, që dalin nga sistemi i cilësisë së miratuar.

4.2. Prodhuesi duhet të lejojë hyrjen e organit të akredituar, për qëllime inspektimi, ndaj prodhimit dhe magazinimit dhe t'i japë atij të gjithë informacionin e domosdoshëm, sidomos:

- dokumentet e sistemit të cilësisë;
- dokumentimet e cilësisë, si për shembull, raportet e inspektimit dhe të dhënat e kontrollit, të dhënat e kalibrimit, raporte të kualifikimit të personelit të interesuar etj.

4.3. Organi i akredituar duhet periodikisht të kryejë kontrolle, për të siguruar që prodhuesi mban dhe zbaton sistemin e cilësisë dhe i jep prodhuesit raportin e kontrollit.

4.4. Përveç kësaj, organi i akredituar mund të bëjë te prodhuesi kontrolle të panjoftuara. Gjatë këtyre kontrolleve, organi i akredituar verifikon funksionimin e sistemit të cilësisë dhe në qoftë se e shikon të domosdoshme, organi i akredituar i jep prodhuesit një raport për kontrollin dhe një raport mbi testin e prodhimit.

5. Prodhuesi duhet të mbajë në dispozicion të autoriteteve kombëtare për një periudhë së paku 10-vjeçare pas datës së fundit të prodhimit të produktit:

- dokumentin për të cilin flitet në nënparagrafin e 3.1;
- rinovimin e fundit për të cilin bëhet fjalë në paragrafin e dytë të 3.4;
- vendimet dhe formularët e raporteve të organit të akredituar, për të cilin flitet në paragrafin e fundit të 3.4, në 4.3 dhe në 4.4.

6. Çdo organ i akredituar duhet t'i japë organeve të tjera të akredituara informacionin përkatës, në lidhje me aprovimet e dhëna dhe të anuluarat të sistemit të cilësisë.

4. MODULI E: Garancia e cilësisë së produktit

1. Ky modul përshkruan procedurën, nëpërmjet së cilës prodhuesi kënaq detyrimet për harmonizimin e ligjeve, të lidhura me lëndët plasëse, siguron dhe deklaron që lëndët plasëse janë në konformitet me tipin, siç përshkruhet në certifikatën ekzaminuese tip EC. Prodhuesi duhet të vendosë shenjë CE në çdo lëndë plasëse dhe të përpilojë një deklaratë me shkrim të konformitetit. Shenja CE duhet të shoqërohet me simbolin e identifikimit të organit të akredituar,

të përgjegjshëm për kontrollet, për të cilat flitet në kreun IV.

2. Prodhuesi duhet të zbatojë një sistem cilësie të miratuar, për inspektimin dhe kontrollin e lëndës plasëse të përfunduar, siç specifikohet në kreun III. Ai duhet të jetë subjekt i kontrolleve, për të cilat flitet në kreun IV.

3. Sistemi i cilësisë

3.1. Prodhuesi paraqet një aplikim tek organi i akredituar, i zgjedhur prej tij për vlerësimin e sistemit të cilësisë për lëndën plasëse të tij. Aplikimi duhet të përmbajë:

- informacionin përkatës për kategorinë e lëndës plasëse që shqyrtohet;
- dokumentin e sistemit të cilësisë;
- dokumentet teknike që i përkasin tipit të miratuar dhe një kopje të certifikatës ekzaminuese EC.

3.2. Sipas sistemit të cilësisë, çdo lëndë plasëse ekzaminohet dhe kontrollohet si duhet, siç përcaktohet në standardet, ose bëhen teste ekuivalente me qëllim që të verifikohet konformiteti i tij me kërkesat përkatëse të ligjit. Të gjitha elementet, kërkesat dhe dispozitat e adoptuara nga prodhuesi duhet të dokumentohen në një mënyrë sistematike dhe të rregullt në formën e politikave, procedurave dhe instruksioneve të shkruara. Ky dokumentim i sistemit të cilësisë duhet të japë mundësinë për t'u interpretuar në një mënyrë uniforme programet, manualët dhe regjistrimet e cilësisë.

Në veçanti ajo duhet të përmbajë një përshkrim të:

- objektivave të cilësisë dhe të strukturës organizative të përgjegjësisë dhe fuqive të drejtimit në lidhje me cilësinë e produktit;
- ekzaminimet dhe testet që do të bëhen pas prodhimit;
- mënyrave të monitorimit dhe veprimeve efektive të sistemit të cilësisë;
- dokumentimeve të cilësisë si, për shembull, të raporteve të inspektimit dhe të dhënave të kontrollit, të raporteve të kualifikimit e personelit të interesuar etj.

3.3. Organi i akredituar duhet të vlerësojë sisemin e cilësisë për të përcaktuar, nëse ai kënaq kërkesat, për të cilat flitet në 3.2. Duhet të presupozohet konformitet me këto kërkesa, në lidhje me sistemet e cilësisë dhe përmbushje të standardit përkatës të harmonizuar.

Një ekip kontrolli duhet të ketë së paku një anëtar me eksperiencë për vlerësimin e teknologjisë të produktit përkatës. Procedura e vlerësimit duhet të përfshijë një inspektim në ambientet e prodhuesit. Prodhuesi duhet të njoftohet për vendimin. Njoftimi duhet të përmbajë konkluzionet e ekzaminimit dhe vendimin e vlerësimit konkret.

3.4. Prodhuesi duhet të marrë përsipër për të plotësuar detyrimet, që dalin nga sistemi i cilësisë së miratuar, për ta mbajtur atë në nivelin e kërkuar. Prodhuesi ose përfaqësuesi i licencuar i tij duhet të mbajnë të informuar organin e akredituar që e ka miratuar sistemin e cilësisë, për çdo ndryshim në këtë sistem të cilësisë.

Organi i akredituar duhet të vlerësojë ndryshimet e propozuara dhe të vendosë nëse sistemi i cilësisë me këto ndryshime kënaq akoma kërkesat, për të cilat flitet në 3.2 ose në se një rivlerësim është i nevojshëm.

Ai duhet të njoftojë prodhuesin për vendimin e tij. Njoftimi duhet të përmbajë konkluzionet e ekzaminimit dhe vendimin e vlerësimit konkret.

4.1. Qëllimi i monitorimit është për të bërë të sigurt që prodhuesi plotëson si duhet detyrimet që dalin nga sistemi i cilësisë së miratuar.

4.2. Prodhuesi duhet të lejojë hyrjen e organit të akredituar për qëllime inspektimi, testimi

dhe magazinimi dhe duhet t'i japë atij të gjithë informacionin e domosdoshëm, sidomos:

- dokumentimin e sistemit të cilësisë;
- dokumentet teknike;

regjistrimet e cilësisë si, për shembull, raportet e inspektimit dhe të dhënat e testit, të dhënat e kalibrimit, raportet e kualifikimit të personelit të interesuar etj.

4.3. Organi i akredituar duhet që periodikisht të bëjë kontrolle për të siguruar që prodhuesi mban dhe zbaton sistemin e cilësisë dhe duhet t'i japë prodhuesit një raport mbi kontrollin.

4.4. Përveç kësaj, organi i akredituar mund të bëjë te prodhuesi kontrolle të panjoftuara. Gjatë këtyre kontrolleve, organi i akredituar bën testime për të verifikuar, që sistemi i cilësisë funksionon korrekt dhe, në rast se e sheh të domosdoshme, organi i akredituar i jep prodhuesit një raport mbi kontrollin dhe një raport mbi testin e bërë.

5. Prodhuesi duhet të mbajë në dispozicion të autoriteteve kombëtare për një periudhë jo më pak se 10 vjet këto dokumente:

- dokumentet, për të cilat flitet në paragrafin 3.1;
- ndryshimet, për të cilat flitet në paragrafin 3.4;
- vendimet dhe raportet e organit të akredituar, për të cilat flitet në paragrafin e fundit 3.4,

4.3 dhe 4.4.

6. Çdo organ i akredituar duhet të dërgojë tek organet e tjera të akredituara informacionin përkatës në lidhje me aprovimet e dhëna dhe të anuluarat të sistemit të cilësisë.

MODULI F : Verifikimi i produktit

1. Ky modul përshkruan procedurën nëpërmjet të cilës një prodhues ose përfaqësues i licencuar i tij, i ngritur brenda komunitetit, kontrollon dhe vërteton që lëndët plasëse, që janë subjekt i dispozitave të këtij ligji, janë në konformitet me tipin, siç përshkruhet në certifikatën ekzaminuese tip EC dhe kënaqin kërkesat përkatëse të ligjit.

2. Prodhuesi duhet të marrë të gjitha masat e domosdoshme, me qëllim që procesi i prodhimit të sigurojë konformitet të lëndëve plasëse, me tipin e përshkruar në certifikatën ekzaminuese tip EC dhe me kërkesat e ligjit, që aplikohen ndaj tyre. Ai duhet të vendosë shenjën CE në çdo lëndë plasëse dhe duhet të përpilojë një deklaratë të konformitetit.

3. Organi i akredituar duhet të bëjë ekzaminimet dhe testet e duhura, me qëllim që të kontrollojë konformitetin e lëndës plasëse me kërkesat përkatëse të ligjit, nëpërmjet ekzaminimit dhe testimit të çdo lënde plasëse, siç përshkruhet në nenin 4.

Prodhuesi ose përfaqësuesi i licencuar i tij duhet të mbajë një kopje të deklaratës së konformitetit, për një periudhë së paku 10-vjeçare pas lëndës plasëse të fundit, që ka qenë prodhuar.

4. Verifikimi nëpërmjet ekzaminimit dhe testimit të çdo lënde plasëse.

4.1. Të gjitha lëndët plasëse duhet të jenë të ekzaminuara individualisht dhe testuar, siç përcaktohet në standardin përkatës, për të cilat flitet në nenin 4 ose bëhen testime ekuivalente, me qëllim që të verifikohet konformiteti i tyre me tipin përkatës dhe kërkesat e ligjit.

4.2. Organi i akredituar duhet të vendosë ose imponon vendosjen e simbolit të identifikimit të tij në çdo lëndë plasëse të miratuar dhe përpilon një certifikatë të konformitetit, në lidhje me testimet e bëra.

4.3. Prodhuesi ose përfaqësuesi i licencuar i tij duhet të sigurojnë që ai është në gjendje të

japë certifikatën e organit të akredituar kur i kërkohet.

MODULI G : Verifikimi i njësisë

1. Ky modul përshkruan procedurën, nëpërmjet së cilës prodhuesi siguron dhe deklaron që lënda plasëse, së cilës i është lëshuar certifikata për të cilën flitet në kreun II, është konform kërkesave përkatëse të ligjit. Prodhuesi duhet të vendosë shenjën CE në lëndën plasëse dhe të përpilojë një deklaratë të konformitetit.

2. Organi i akredituar duhet të ekzaminojë lëndën plasëse dhe të bëjë testet e duhura, siç përcaktohet në standardin përkatës ose të bëjë teste ekuivalente, për të siguruar konformitetin e tij me kërkesat përkatëse të ligjit.

Organi i akredituar duhet të vendosë ose imponojë vendosjen e simbolit të identifikimit mbi lëndën plasëse të miratuar dhe të përpilojë një certifikatë të konformitetit në lidhje me testet e bëra.

3. Synimi i dokumenteve teknike është për të dhënë mundësi, që të vlerësohet konformiteti me kërkesat e ligjit dhe që të kuptohet projekti, prodhimi dhe funksionimi i lëndës plasëse.

Dokumentet duhet të përmbajnë aq sa është e domosdoshme për vlerësim:

- një përshkrim të përgjithshëm të tipit;
- projektin konceptual dhe skicat e prodhimit e skemën e komponentëve etj.;
- përshkrimet dhe shpjegimet e domosdoshme për kuptimin e skicave të thëna më sipër, skemat dhe funksionimin e lëndës plasëse ose sistemin e mbrojtjes;
- një listë të standardeve të zbatuara plotësisht ose pjesërisht dhe përshkrimet e zgjidhjeve të adoptuara, për të plotësuar kërkesat esenciale të ligjit, atje ku këto standarde nuk kanë qenë plotësuar;
- rezultatet e bëra të kalkulimeve të projektit, ekzaminimet e bëra etj.;
- raportet e testit.